



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr. 135/11

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në çështjen juridike të paditësve N. Th. S. Th. dhe K. K., të gjithë nga fshati ... Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. I. H. nga Prishtina, kundër të paditurës B. K. e S. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson D. H. nga Prishtina, me objekt të padisë kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 58.695.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në munges të palës së paditur, me datë **27.05.2015**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësve N. Th. dhe S. Th., të dyja nga fshati ... Komuna e Prizrenit.

II. DETYROHET e paditura B. K. e S. me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material për shkak të lëndimit në aksidentin e ndodhur me datë 21.11.2010, t'i paguaj paditëses N. Th. shumat si në vijim:

a). Dëmi jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore), shumë prej.....5000 €.
- Për frikë, shumë prej4000 €.
- Për shëmtim të shkallës mesatare, shumë prej..... 3000 €.
- Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvoglimit të aktivitetit jetësor...5000 €, apo shumë e përgjithshme prej **17,000.00 €**, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar në Bankat Komerciale të R. Kosovës, duke e llogaritur atë nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (27.05.2015) e deri te pagesa definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

b). Dëmi material:

- Për ushqim të përforcuar shumë prej.....500 €.
- Në emër të kompensimit të shpenzimeve për trajtim mjekësor në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë (QKUK).....70 €.
- Në emër të kompensimit të dëmit material për fitimin e humbur-rentës për shkak të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për periudhën nga dita e aksidentit datë 21.11.2010 e deri me datë 31.05.2015, e paditura ti paguajë shumë prej **7,978.47 €**. Ndërsa për periudhën prej datës 01.04.2015 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të fitimit të humbur-rentës ti paguajë shumë

mujore prej 158.76 € në muaj, e cila shumë duhet t'i paguhet paditëses në çdo fillim muaji nga datat 1 deri 5 të çdo muaji vijues, ndërsa të gjitha këto me kamatë ligjore sikurse për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar në Bankat Komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga data e shkaktimit të dëmit (21.11.2010) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë

c). Shuma e përgjithshme të cilën e paditura B. K. e S. me seli në Prishtinë, ka për obligim që t'ia paguajë paditëses N. Th. në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të cekura në pikën a) dhe b), të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është **25,548.47 €**, pa llogaritur këtu shumën prej 158.76 €, e cila shumë duhet t'i paguhet paditëses çdo muaj nga e paditura në emër të rentës mujore për shkak të fitimit të humbur, ashtu siç është cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura B. K. e S. me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material për shkak të lëndimit në aksidentin e ndodhur me datë 21.11.2010, t'i paguaj paditëses S. Th. shumat si në vijim:

- Për dhimbje fizike (trupore), shumën prej.....1000 €.
- Për shëmtim të shkallës së ulët, shumën prej..... 800 €.
- Për frikë, shumën prej1000 €.
- Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....100 €, apo shumën e përgjithshme prej **2,900.00 €**, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar në Bankat Komerciale të R. Kosovës, duke e llogaritur atë nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (27.05.2015) e deri te pagesa definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

IV. DETYROHET e paditura B. K. e S. me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditësve shumën prej **2,587.00 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

V. Kërkesëpadia e paditësve N. Th. dhe S. Th., përtej shumës së aprovuar, e të cekur në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përfshirë këtu edhe pjesën e kërkesëpadiës për rehabilitim fizioterapeutik-klimatik dhe ndihmë personit të tretë, **refuzohet si e pabazuar.**

VI. KONSTATOHET se padia e paditësve K. K. nga Prizreni, e parashtruar kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, **është tërhequr.**

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë së palës së paditur, konform nenit 423 paragraf 3 të LPK-së.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av.I. H. nga Prishtina, me datën 01.03.2011, kanë parshtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren (të cilën së fundmi e kanë precizuar përmes parashtresës së datës 20 Dhjetor 2014, me të

cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të demit jomaterial dhe material nga baza e autopërgjegjesisë për lëndimet e pësuar në aksidentin e datës 21.11.2010, ti paguaj paditësve N. Th. dhe S. Th., shumat e kërkuara në kërkesë padi dhe në precizimin e saj, të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës.

1. Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), më saktësisht nenit 200 të LMD-së, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: *“Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”*. Meqenëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia e detyrimeve, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale nenit 47.1 i LPK-së thotë: *“Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit”*, ndërsa parag. 2 i të njëjtit nen thotë: *“Në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është, përpos gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin”*. Meqenëse dëmi në rastin konkret është shkaktuar në territorin e Komunës së Prizrenit, si dhe paditësit vendbanimin e kanë në Komunën e Prizrenit, rezultoi se kompetente në pikëpamje territoriale për shqyrtimin e kësaj çështjeje juridiko-civile është kjo gjykatë.

Paditësit, legjitimohen t'i drejtohen gjykatës me këtë padi, pasi kanë amrrë lëndime trupore në aksidentin e cekur më lartë dhe bazuar në nenin 200 të LMD-së dhe jo vetëm, parashihet se për dhimbjet e pësuar fizike, shirtërore etj, gjykata do ti gjykoj kompensim të drejtë në të holla, ndërsa në rastin konkret rezultonë se paditëset kanë pësuar këto lloje të dhimbjeve etj. Pala e paditur ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike nga baza e autopërgjegjesisë, meqenëse automjeti i cili ka qenë i përfshirë në aksident nuk ka qenë i siguruar dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, këto raste mbulohen nga B. K. e S.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësve av. I. H., në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar, si dhe precizimit të kërkesëpadisë të bërë përmes parashtrësës së datës 20.12.2014, duke shtuar se nuk është kontestues fakti se me datë 21.11.2010, rreth ores 10:50 në rrugën Nashec-Prizren, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ndërsa këtë aksident e

ka shkaktuar vozitësi i automjetit të pasiguruar "Opel Kadet" me targa regj. ...-KS-..., të cilin e ka drejtuar F. B., i cili duke mos ia përshtatur shpejtësinë e levizjes dhe kushteve të rrugës në një kthesë të padukshme në të majtë e humb kontrollin, duke kaluar në shiritin e kundërt dhe më pas duke u përpjekur që të kalojë prapë në shiritin e tij, duke u bartur me veturë gjatë rrugës, me pjesën e përparme të djathtë godet këmbësorët që po ecnin para tij, me ç'rast këmbësoren N. Th. e hedh jashtë rrugës, ndërsa bashkëshortin e saj tani të ndjerin H. Th. e bartë me veturë deri në pozitën përfundimtare, duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse, me ç'rast i njëjti vdes në vendin e ngjarjes, ndërsa vajza e tij S. dhe vajza e mikut të tij K. marrin lëndime të lehta trupore. Nga mendimi i ekspertëve mjekësor ka rezultuar se paditësja N. Th. ka pësuar lëndime të rënda trupore, ashtu siq është përshkruar në detaje në ekspertizën e tyre të dhënë në procesverbalin e datës 16.12.2014, ku përveq konstatimit se paditësja N. Th. ka pësuar lëndime të rënda trupore, e njejtja ka përjetuar edhe frikë, shëmtim trupor, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor me pasoja të përhershme në shëndetin e saj. Andaj, të njejtës edhe i takon edhe e drejta e kompensimit real për dhimbjet e përjetuara dhe format e tjera të kompensimit të dëmit material dhe jo material të specifikuara në parashtrësën për precizimin e kërkesë padisë. Gjithashtu në këtë aksident lëndime trupore ka pësuar edhe paditësja S. Th., lëndime këto të përshkruara detalisht nga ekspertët përkatës gjatë egzaminimit të saj në shqyrtimin kryesor. Si rezultat e këtyre lëndimeve, paditëses S. Th. i takon e drejta e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, në shumat e precizuara me parashtrësën e datës 20.12.2014. Më tutje ka shtuar se në bazë të provave materiale jo kontestuese, faktit se shkaktuesi i aksidentit F. B. ka shkaktuar aksidentin me veturën e pasiguruar, si rezultat i së cilës me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr. 56/11 të dt. 28.03.2011, është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, njëherit duke patur parasysh dispozitat ligjore të parapara me nenin 14 të LPK-së, si dhe dispozitat ligjore të aplikueshme të parapara me nenin 201 të LMD-së, lidhur me Rregullin nr. 3 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të nxjerr nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, rezulton se baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar plotësisht. Në fund ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve dhe të obligoj të paditurën që t'ia paguajë paditësve shumat e kërkuara në kërkesëpadi, përfshirë këtu edhe kompensimin e dëmit material në emër të fitimit të humbur për shkak të mbajtjes për paditësit N. Th. dhe U. Th. (sikurse në ekspertizën e ekspertit aktuar), si dhe shpenzimet procedurale të specifikuara në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë së datës 20.12.2014 dhe procesverbalin e datës 25.02.2015.

Edhe pse i autorizuari i të paditurës D. H. nuk ka prezentuar në shqyrtimin e fundit kryesor, në shqyrtimin pregaditor dhe në shqyrtimet e mbajtura deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjegjës së dhënë në padi, deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, përmes të cilave e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e padisëve, mirëpo e ka kontestuar edhe të drejtën e paditësve për kërkuar kompensimin e dëmit, pasi që sipas tij paditësit kanë hjekur dorë nga kërkesa pasurore juridike në procedurën penale të zhvilluar në Prokurorinë e Qarkut në Prizren (më gjerësisht referoju deklarimeve të të autorizuarit të paditurës në shqyrtimet e mbajtura).

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: raportin policor për aksidentin e ndodhur numër 2010-Gr-1574, date 21.11.2010, ekspertizën e komunikacionit të datës 13.01.2011, të hartuar nga eksperti J. B., çertifikatën e lindjes për N. Th., me nr.11, datë 07.12.2010, raportin mjekësor të Qendrës

Emergjente në Prizren me nr.38099, datë 21.11.2010, fletëlëshimin e ortoperdisë dhe traumatologjisë me numër 1815 datë 31.12.2010, çertifikatën e lindjes për paditësen S. Th., me nr.5 datë 07.12.2010, raportin mjekësor të Spitalit rajonal të Prizrenit nr.27622, datë 22.12.2010, e lëshuar për paditësen S. Th., raportin e specialistit Dr.M. G. datë 09.12.2010 dhe datë 13.12.2010, për paditësen S. Th., aktgjykimin e plotëfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.56/11, datë 28.03 2011, ekspertizën e ekspertit aktuar të datës 16.03.2015, ka dëgjuar ekspertin aktuar A. G., ka dëgjuar ekspertët mjekësor Dr.Xh. S. ortoped-traumatolog dhe Dr.N. F. psikiatër.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e bazuar**.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Nga vlerësimi i provave të administruara, gjykatës i rezultoi se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se me datë 21.11.2010, rreth orës 10:50 në rrugën Nashec-Prizren, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ndërsa këtë aksident e ka shkaktuar vozitësi i automjetit të pasiguruar "Opel Kadet" me targa regj. ...-KS-..., të cilin e ka drejtuar F. B., i cili duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës në një kthesë të padukshme në të majtë e humb kontrollin, duke kaluar në shiritin e kundërt dhe më pas duke u përpjekur që të kalojë prapë në shiritin e tij, duke u bartur me veturë gjatë rrugës, me pjesën e përparme të djathtë godet këmbësorët që po ecnin para tij, me ç'rast këmbësoren N. Th. e hedh jashtë rrugës duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, ndërsa bashkëshortin e saj tani të ndjerin H. Th. e bartë me veturë deri në pozitën përfundimtare, duke i shkaktuar lëndime vdejekeprurëse, me ç'rast i njëjti vdes në vendin e ngjarjes, ndërsa vajza e tij S. dhe vajza e mikut të tij Krijesa marrin lëndime të lehta trupore.

Gjithashtu ndërmjet palëve ndërgjyqëse, por edhe për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se aksidentin e ka shkaktuar F. B., për çka edhe i njëjti është shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin e plotëfuqishëm P.nr.56/11, datë 28.03.2011. Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se F. B. me rastin e shkaktimit të aksidentit, si pasojë e të cilit ka ndërruar jetë tani i ndjeri H. Th. dhe janë lënduar këtu paditëset N. dhe S. Th., ka vozitur veturën e cila ka qenë e pasiguruar, ku për këtë shkak edhe e paditura ka legjitimacion real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Nga çertifikata e lindjes për paditësen N. Th., me nr. 11, datë 07.12.2010, gjykata vërtetoi faktin se kjo e fundit ka lindur më datë ... në ..-Komuna e Prizrenit.

Nga çertifikata e lindjes për paditësen S. Th., me nr.5, datë 07.12.2010, Gjykata vërtetoi faktin se kjo e fundit ka lindur më datë Komuna e Prizrenit.

Nga aktgjykimi penal P.nr.56/11, datë 28.03.2011, i marr nga Gjykata e Qarkut në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se i akuzuari F. B. nga fsh.... Komuna e Prizrenit, shpallet fajtor për veprën penale rrezikim i trafikut publik, për shkak të

shkaktimit të aksidentit në trafik, ku si pasojë e lëndimeve të marra tani i ndjeri H. Th. vdes në vendin e ngjarjes, ndërsa paditësja N. Th. merr lëndime të rënda trupore, kurse paditësja S. Th. lëndime të lehta trupore. Si rezultat i kësaj gjykata konsideron se meqenëse automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti (pronë e F. B.) ka qenë i pa siguruar, atëherë nga baza e autopërgjegjesisë lindë detyrimi i të paditurës që të kompensojë dëmin e shkaktuar, e që do të thotë se e paditura ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike konform Rregullit nr. 3 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të nxjerr nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, e që ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të aksidentit.

Eksperti mjekësor Dr. Xh. S., përndryshe ortoped-traumatolog në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të paditësës N. Th. në shqyrtimin e mbajtur më datë 16.12.2014, ndër të tjera ka konstatuar se: paditësja N. Th. ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë zhvendosje qëndrore e filgjanit të kordhokllës së majtë, thyerje e fletës ilijake të majtë, thyerje e krahëve të sipërmë dhe të poshtëm të kockës së trupit të majtë, plagë prerëse- dërmishëse në pjesën e jashtme të gishtit të vogël të dorës së majtë. Këto lëndime paditësës i kanë shkaktuar **dhimbje fizike: a) të intenzitetit posaqërishtë të rëndë-** një orë e gjysmë, koha e e nevojshme nga momenti i aksidentit, transportit, procedura diagnostifikuese, e deri në fillimin e mjekimit, **b) të intenzitetit të rëndë-** 5 ditë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve, **c) të intenzitetit të mesëm-** 50 (pesëdhjetë ditë), koha e nevojshme, për fillimin e kunsulidimit kockor parësor të kockat e mëdha janë në raport me moshën, **c) të intenzitetit të ulët-** ku edhe sot e kësaj dite ka ngarkesë gjatë ecjes për shkak të shkurtesës së këmbës së majtë, astrozës (degjenerimit), të nyjës së kërdhokullës së majtë e cila është e zhvendosur në drejtim të pelvikut si dhe kufizimit të lëvizjeve të kësaj kërdhokulle, si pasojë e kësaj artroze dhe shkurtesës, si dhe gjatë ndryshimeve klimatike, dhimbje këto të shprehura në kërdhokullën e majtë, hijet dhe pjesët belore të bushtit kurrizor. **Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor-** që është i shprehur në shkallën prej 40 %, për shkak të thyerjes qëndrore të filgjanit me zhvendosje, i cili për pasojë ka dhënë deformim dhe artrozën e kërdhokullës së majtë me kufizim të lëvizjesh me shkallë të mesme pika 189 B, thyerjes me zhvendosje të krahut të sipërm dhe të poshtëm të kockës së trupit të majtë, pika 104, si dhe shkurtesës së këmbës së majtë me 2,5 c, pika 197 a, në lidhmëri me pikën 3 dhe 6 të vërejtjeve të tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ndërlidhur me pikën 3 dhe 6 të vërejtjeve të tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ndërlidhur me pikën 3 dhe 6 të vërejtjeve hyrëse të kësaj tabele. **Zvoglim të aktivitetit punues-** për punët që kërkojnë mund të rëndë vizikë si në amvisni dhe bujqësi është I shprehur në shkallën prej 50 %. **Shëmtim trupor-** shkalla mesatare për shkak të qalimit me këmbën e majtë, plagëve të çrregullta mbi gjurin e majtë në të dyja anët e mbigjurit me perimenter 1.5 x 1.5 cm, në pjesën e sipërme dhe anash kërdhokullës së majtë, dy vraja afër me perimenter 3x 1.5 cm, vrajes në pjesën e pasme dhe të poshtme të muskulit blutues maksimum me perimenter 9 x 6 cm, e cila është e thellë dhe e çrregullt, e shkatëruar nga qëndrimi i gjatë në shtratë (derkubitus), si dhe vrajes në pjesën e jashtme të gishtit të vogël të dorës së majtë me gjatësi 3,5 cm. **Poashtu ndihma e huaj-** ka qenë e nevojshme për 4 muaj dhe për disa lloje të ndihmës (siç është mbathja e qorapeve dhe e këpucëve nga këmba e majtë ku dhe do të ketë nevojë gjerë në implatimin e endoprotezës totale të kërdhokullës së majtë. Po ashtu ka qenë e nevojshme edhe **ushqimi i përforcuar-** në kohëzgjatje prej 6 muajsh, i pasur me proteina, albumina, vitamina, minerale dhe karbohidrate. Po ashtu

rehabilitimi fizioterapeutik klimatik- ka qenë i nevojshëm për 2 muaj brenda 2 viteve pas aksidentit.

Eksperti mjekësor Dr. F. D., përndryshe psikiatër në Institutin Ligjor për forenzikë në Prishtinë, pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të paditëses N. Th. në shqyrtimin e mbajtur më datë 16.12.2014, ndër të tjera ka konstatuar se: përjashtohet frika primare tek paditësja meqenëse e njëjta në momentin e aksidentit nuk e kishte parë me sytë e saj momentin e ndodhjes së aksidentit. **Frikë sekondare e intensitetit të lartë-** e cila nënkupton rrjedhën e gjendjes së saj pas aksidentit ku ishte një gjendje e rëndë me turbullime të vetëdijes, kështu që e njëjta gjendjen e saj e percepton pas ardhjes në vete ku fillojnë ankthe, mërzitja, pritjes se çka do të ndodh më tutje. Në aspektin psiçik vërtetë sipas të dhënave dhe gjetjeve, është në gjendje mjaftë të rëndë, e cila vlerësohet se e njëjta ka përjetuar frikë sekondare, e cila frikë sekondare është e intensitetit të lartë, që ka zgjatur 7 ditë, **frikë sekondare të intensitetit mesatar-** janë peripetitë, preokupimet, frika, pagjumsia, dhembjet, pozita të detyruara, (duke e ditur natyrën e rëndë të lëndimeve të pësuar). Të gjitha këto shqetësime vlerësohen se paditësja ka përjetuar frikën sekondare mesatare e cila ka zgjatur 5 muaj. **Frikë sekondare të intensitetit të ulët-** janë shqetësimet e kohë paskohshme të cilat lidhen me mërzitjen për shkak të pasojave që lidhen me lëndimet përkatëse. Ato janë në formë të pagjumësisë, anktheve, mërzitjes, depresionit, kjo frikë e intensitetit të ulët ka zgjatur 6 muaj.

Eksperti mjekësor Dr. Xh. S., përndryshe ortoped-traumatolog në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës si dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të paditëses S. Th., në shqyrtimin e mbajtur më datë 16.12.2014, ndër të tjera ka konstatuar: paditësja S. Th. ka pësuar **dhimbje fizike të intensitetit të rëndë- 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve, intensitet të mesëm 14 ditë, të intensitetit të ulët-** ka edhe sot e kësaj dite në formë të dhimbjeve dhe mpirjeve të regjionit të pjesës së pasme të kofshës së majtë. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithëshëm jetësor nuk ekziston. Shkallë e lehtë e shëmtimit trupor (për shkak të shembjes muskulo-lëkuror në pjesën e pasme të mesme të kofshës së majtë me përmasa 11,5x12 cm. Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme 14 ditë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohë zgjatje prej 21 ditë i pasur me proteina, albumina, vitamin, minerale dhe karbohidrate. Rehabilitimi fizeoterapeutik ka qenë i nevojshëm për 15 ditë brenda vitit të parë pas aksidentit.

Eksperti mjekësor Dr. F. D., përndryshe psikiatër në institutin ligjorë në Prishtinë, pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të S. Th. në shqyrtimin e mbajtur më datë 16.12.2014, ndër të tjera ka konstatuar: paditësja S. Th. përjashtohet nga frika primare për shkak të rrethanave të caktuara ku e njëjta nuk e kishte parë me sytë e saj momentin e aksidentit. Frikë sekondare e intensitetit të lartë janë shqetësimet, ku e cila për shkak të rrethanave nuk është paraqitur te mjeku, për shkak të lëndimeve ku pasur konsikuenca në sferën psiçike, mërzitje, ndrotje etj, këto vlerësohen në kohë zgjatje prej 3 orë. Frikë sekondare e intensitetit mesatar janë shqetësimet në vazhdim të cilat janë manifestuar në pagjumësi, ankthë, peripetitë, preokupimet, frika, pagjumësitë, dhembjet, pozita të detyruara (duke ditur natyrën e rëndë të lëndimeve të pësuar). Të gjitha këto shqetësime vlerësohen se e njëjta ka përjetuar frikën mesatare e cila ka zgjatur 1 muaj. Frikë sekondare të intensitetit të ulët, janë

shqetësimet e kohë paskohshme të cilat lidhen me mërzitjen për shkak të pasojave që lidhen me lëndimet përkatëse. Ato janë në formë të pagjumsisë, anktheve, mërzitjes, depresionit. Kjo frikë e intenzitetit të ulët ka zgjatur një muaj.

Eksperti aktuar A.G., në ekspertizën e tij të datës 16.03.2015, ndër të tjera ka konstatuar: paditëses së aksidentuar N. Th. nga fshati ...-KK Prizren, si pasojë e lëndimeve të saj në aksidentin e komunikacionit të datës 21.11.2010 dhe reduktimi të aftësisë së saj punuese për 50%, përpos në lloje të tjera të demit i takon edhe e drejta e kompensimit të demit material të formës së fitimit të humbur – rentës e cila arrinë vlerën prej: a) për periudhën e kaluar prej aksidentit 21.11.2010 e deri më 31.03.2015 në shumë prej 7,978,47 euro që së bashku me kamatë të llogaritur sipas arritjeve mujore për pagesë mujore për pagesë e normë si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar prej 3.5 % vjetore, prej ditës së ushtrimit të padisë më 01.03.2015 e deri më tani 31.03.2015, prej 597.88 euro, arrinë në gjithsej 8,576.35 euro dhe b) për periudhën e ardhshme prej 01.04.2015 e tutje(deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore), në shumë mujore prej nga R= 158.76 euro, e cila e paguar në formë të menjëhershme-të kapitalizuar arrinë vlerën prej gjithësej: 8,576.35 +20,509.57=29,085.92 (Më gjerësisht referoju ekspertizës e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Meqenëse i gjithë dokumentacioni mjeksor që gjendet në shkresat e lëndës është vlerësuar nga ekspertët përkatës dhe të njëjtat janë pjesë të ekspertizës së dhënë, në pajtim me palët ndërgjyqëse, gjykata nuk e pa të arsyeshme që të bëjë vlerësimin e secilës prej tyre veç e veç.

4. Baza Ligjore

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 (që ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimin të demit) e rregullon çështjen e kompensimit të demit (material dhe jo material). Neni 178 i LMD-së, par.1 thotë: *“Në rast aksidenti të shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”,* par.2 thotë: *“Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për demin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre”,* par.3 thotë: *“Në qoftëse nuk ka fajësi në asnjë anë, zotëruesit përgjigjen në pjesë të barabarta, nëqoftëse shkaqet e drejtësisë nuk kërkojnë gjë tjetër”,* par.4 thotë: *“Për demin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjetëve përgjigjen solidarisht”.*

Neni 188 paragrafi 1 dhe 2 i LMD-së thotë: *“Në rast të vdekjes, dëmtimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, kompensimi si rregull caktohet në formë të rentës në të holla, për të gjithë jetën ose për një kohë të caktuar, ndërsa renta në të holla, e gjykuar për efekt të kompensimit të demit paguhet çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër”.*

Neni 194 në paragraf 1 dhe 2 të LMD-së thotë: *“Personi të cilin i vrari e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht, si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga i vrari, ka të drejtë kompensimit të demit që pëson nga humbaj e ushqimit ose të ndihmës. Ky dëm kompensohet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga i vrari po të mbetej gjallë”.*

Neni 200 i LMD-së par.1 thotë: *“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, të vdekjes së personit të afërm etj, gjykata do të*

gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i demit material...”, ndërsa parag.2 thotë: “Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e demit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata merr parasysh rendësinë e shkëlqës së të mires dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj...”. Neni 201 i LMD-së, parag.1 thotë: “Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’u gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore...”.

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të cilën e kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar në ligj dhe fakte.

Siç është cekur edhe në pikën 3 të arsytimit të këtij aktgjykimi, baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve nuk ishte kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, andaj gjykata konform nenit 321.2 të LPK-se nuk e pa të nevojshme që edhe njëherë të provoj faktet që kanë të bëjnë me vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë, por drejtëpërdrejtë të vlerësojë dhe të përcaktoj shumatat adekuate (të përshtatshme) që duhet të paguajë e paditura në emër të kompensimit të demit material dhe jo material që i është shkaktuar paditësve, për shkak të lëndimeve të pësuar, të cilat janë përshkruar më detalisht më lartë, e që rrjedhë nga baza e autopërgjegjësisë për shkak të aksidentit të ndodhur me datë 21.11.2010, përfshirë këtu edhe kompensimin e demit material në emër të fitimit të humbur për paditësen N. Th.

Nga të lartcekurat, gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse për të kompensimin e dëmit këtu paditësve, konform përgjegjësisë në bazë të autopërgjegjësisë të parashikuara me Rregullën nr. 3 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësitë, të miratuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në lidhje me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), pasi që për automjetet të cilat janë të pasigurura në Kosovë, në rast të shkaktimit të aksidentit, dëmet mbulohen nga Byroja Kosovare e Sigurimit, fakt ky i pakontestuar nga pala e paditur. Këtë çështje në mënyrë specifike e rregullon neni 4 paragraf 1 pika a. e Rregullës nr. 3 për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ku ndër të tjera është përcaktuar se Fondi Garantues (tani B. K. e S.) bën pagesën e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i automjetit, për të cilin sigurimi i detyrueshëm nuk është kontraktuar në pajtim me këtë rregull etj.

Në rastin konkret gjykata ka zbatuar edhe parimin juridik **condicio sine qua non**, sipas të cilit ardhja e pasojës së dëmshme nuk do të vërtetohej, nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit. Ndërsa me lidhjen shkakësore juridike vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe çënimeve konkrete të pësuar në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe te personat e tjerë që rezultojnë të dëmtuar si rrjedhojë e pasojave që vijnë nga i njëjti fakt i paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmërisë të lidhjes shkakësore. Nga të

lartcekurat gjykata vërtetoi faktin se ekziston lidhja shkakësore juridike në mes aksidentit të ndodhur dhe lëndimit të paditësve N. dhe S. Th., të cilin fakt gjykata e vërtetoi nga provat materiale të administruara, më saktësisht në bazë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P.nr.56/11, date 28.03.2011, ku në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se shkaktar i aksidentit është F.B.

Nga të lartcekurat dhe duke marr parasysh rrethanat e rastit konkret, gjykata konstatoi se paditësja N. Th. si pasojë e lëndimeve të rënda trupore të pësuar në aksidentin e dates 21.11.2010, ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, dhimbje shpirtërore për shkak të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të intenzitetit të lartë, shëmtim trupor të nivelit mesatar, zvoglim të aktivitetit jetësor prej 40 %, zvoglim të aktivitetit punues prej 50 %, etj, ashtu siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në pikën 3 të arsytimit të këtij aktgjykimi, andaj të njëjtës i takon e drejta e kompensimit të dëmit jo material dhe material, e që mund të jetë një formë e sfatisfaksionit moral për paditësen. Gjithashtu u vërtetua fakti se edhe paditësja S. Th. në aksidentin e cekur më lartë ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe si rezultat i këtij lëndimi ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, shëmtim të lehtë trupor etj, ashtu siç e kanë konstatuar ekspertët mjekësor, për çka edhe të njëjtës i takon kompensimi adekuat.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së lidhur me në nenin 154 të LMD-së, i aplikueshëm i cili përcakton: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij "*, lidhur me nenet 178, 185, 186, 187, 188, 195 dhe 200 të LMD-së.

Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditëset nga aksidenti i shkaktuar, e që ekspertët përkatës kanë vlerësuar se lëndimet e paditëses N. Th. janë lëndime të karakterit të rëndë trupor me pasoja të përhershme në shëndetin e saj, ndërsa lëndimet e paditëses S.Th. janë vlerësuar si lëndime me karakter të lehtë trupor. Andaj, edhe lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarve-paditësve satisfaksion që ato të jetë në gjendje ti kompensojnë të mirat jomateriale nga të cilat janë privuar, e kjo duke marr parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intenzitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, shëmtimit mesatar trupor për paditësen N., zvoglimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 40 %, zvoglimin e aftësisë për punë në masën prej 50% dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilën e kemi përmendur më lartë, të cilave gjykata ja fali besimin e plotë. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit, si dhe lidhur me shumën e kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka marr për bazë rendësinë e shkëlqës së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të, të mos u shkojë përshtatë synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimit të tij shoqëror.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin jo material, gjykata ka vlerësuar se e njëjta rrjedh për pagesë

nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e që në rastin konkret është 27.05.2015, kjo bazuar në nenin 277 të LMD-së, lidhur me nenin 186 LMD-së¹.

Gjykata ka vlerësuar se në bazë të nenit 195 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së, lidhur me nenin 188 të LMD-së, paditëses N. Th. i takon e drejta për kompensimin e dëmit material në emër të fitimit të humbur për shkak të zvoglimit të aftësisë për punë, e cila nga eksperti përkatës u vlerësua në masën 50 %. Andaj, edhe vendosi që të aprovojë në tërësi këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditëses, ku në bazë të llogaritjeve që rrjedhin nga ekspertiza e ekspertit aktuar A. G., së cilës gjykata ja fali besimin e plotë, vendosi që paditës N. Th., në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të fitimit të humbur-rentës, për periudhën nga dita e aksidentit datë 21.11.2010 e deri me datë 31.05.2015, e paditura ti paguajë shumën prej **7,978.47 €**. Ndërsa për periudhën prej datës 01.04.2015 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të fitimit të humbur-rentës ti paguajë shumën mujore prej 158.76 € në muaj, e cila shumë duhet t'i paguhet paditëses në çdo fillim muaji nga datat 1 deri 5 të çdo muaji vijues. Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin material për shkak të fitimit të humbur në emër të rentës, gjykata ka vlerësuar se e njëjta rrjedh për pagesë nga data e shkaktimit të dëmit, e që në rastin konkret është 21.11.2010, kjo bazuar në nenin 277 të LMD-së, lidhur me nenin 186 LMD-së. Për këto arsye gjykata nuk e ka pranuar llogaritjen e kamatës ligjore nga ana e ekspertit aktuar, duke ju referuar edhe praktikës gjyqësore në lidhje me lartësinë e kamatës, pasi që LMD-ja që ka qenë fuqi nuk ka ndonjë dispozitë që përcakton se sa duhet të jetë lartësia e kamatës në rastet e kompensimit të dëmit. Gjykata ka pranuar shumën e shpenzimeve të mjekimit për paditësen N. Th. në shumë prej 70 euro, bazuar në faturat e ofrura nga pala paditëse, të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për pikën **IV** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, në të cilat janë përfshirë, 156 € për përpilim të padisë (104 x 1.5=156, pasi janë dy paditës), 234 euro për përpilimin e tri parashtrësive, 50 € për pagimin e taksës gjyqësore, 700 € për ekspertizën gjyqësore, për përfaqësim në pesë seanca gjyqësore nga 135.20 në shumë prej 1,014 € (përfaqësim i dy paditësve 135.20x1.5x5 seanca=1,014 €), gjithësejtë shumën prej **2,587.00 €**.

Gjykata vendosi si në pikën **V** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, ku rezultoi se kërkesëpadia e paditësve përtej shumës së aprovuar, e të cekur në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është e pabazuar, pasi gjykata vlerësoi se shumatat e gjykuara janë të përshtatshme dhe në përputhje edhe me natyrën e lëndimeve të paditësve. Gjithashtu gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që paditësve në emër të rehabilitimit fizioterapeutik-klimatik dhe ndihmës së personit të tretë të paguajë shumatat e kërkuara me kërkesëpadi, për faktin se pala paditëse nuk i ofroi gjykatës asnjë provë materiale (fakturë etj) që do të vërtetonte pretendimet e saj. Andaj në mungesë të provave e refuzoi këtë pjesë të kërkesëpadisë si të pabazuar.

¹ Shih aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.295/2008, date 17.01.2011, me të cilin është qartësuar çështja e llogaritjes së kamatës tek dëmi material dhe jo material.

Gjykata vendosi si në pikën **VI** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 261.3 të LPK-së, për faktin se i autorizuari i paditësve përmes parashtresës së datës 20.12.2014, ka deklaruar se e tërheqë padinë për paditësen Krijesa Kryeziu.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur, të bëra përmes parashtresës së dates 21.04.2015, me të cilën kanë kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pabazuar, për shkak se pala paditëse në procedurë penale të zhvilluar para Prokurorisë kompetente ka hjekur dorë nga kërkesa pasurore juridike. Mirëpo, ka ardhur në përfundim se të njëjtat pretendime janë plotësisht të pabaza, për faktin se marrëveshja të cilës i referohet e paditura është lidhur në procedurë e zhvilluar në prokurori për pranimin e fajësisë nga shkaktari i aksidentit F. B. dhe ka pasur të bëjë ekskluzivisht me fajësinë e këtij të fundit, mirëpo kjo marrëveshje nuk është pranuar nga Gjykata. Kështu që është zhvilluar procedura e rregullt në gjykatë, ku paditësit shprehimisht kanë deklaruar se parashtrojnë kërkesë pasurore juridike (shih faqen 3 të aktgjykimit P.nr.56/11, date 28.03.2011) dhe në dispozitivin e aktgjykimit të dëmtuarat N. Th. S. Th. dhe K. K. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil. Nga kjo rrjedhë se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe nuk ka ndonjë pengesë faktike apo juridike që të mos procedohet me të.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenin 154, 178, 185, 186, 187, 188, 195 dhe 200 të LMD-së lidhur me nenin 323 dhe 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.135/11, datë 27.05.2015

Procesmbajtësja,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.